

PËLQIM PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Me klikimin e Pëlqimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me vullnetin tim jap pëlqimin tim që Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A. mund të mbledhë, përdorë, zbulojë dhe përpunojë të dhënat e mia personale me qëllim të përpunimit të tyre që sipas ligjit janë të domosdoshme për aplikimin e kredisë, mbitërheqjes, aplikacionin e kartës së kreditit dhe produkteve të tjera bankare, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe që përfshin, por nuk kufizohet në:

a) përpunimin e kërkesës time për dhe sigurimin e shërbimeve dhe produkteve të bankës, partnerëve afaristë dhe kompanive të ndërlidhura; dhe

b) administrimin dhe/ose menaxhimin e marrëdhënieve dhe/ose llogarive bankare;

Të dhënat personale të cilat do të përpunohen nga ana e bankës përfshijnë, por nuk kufizohet në:

- a) Emrin dhe mbiemrin;
- b) Numrin personal apo numri i dokumentit;
- c) Datë e lindjes;
- d) Adresën e banimit;
- e) Numrin e telefonit;
- f) Email adresën;
- g) Të dhëna të tjera financiare;

Unë pranoj se të dhënat e mia personale mund të zbulohen nga Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A. për ofruesit e shërbimit të palës së tretë, agjentët (duke përfshirë Firmat Ligjore dhe kompanitë e kontraktuara), të angazhuara nga banka, qoftë brenda ose jashtë Kosovës (Lista e vendeve dhe Organizatave nderkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale sipas publikimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi e Publikuar në Gazetën Zyrtare) apo vendet jashtë listës sipas miratimit nga Agjencioni të cilat do të përpunojnë të dhënat personale për bankën për një ose më shumë nga qëllimet e mësipërme sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Jam informuar se kam qasje dhe të drejtë për të kërkuar korigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin, kundërshtimin dhe tërheqjen e pëlqimit të përpunimit të të dhënave në çdo kohë lidhur me subjektin e të dhënave pa efekt prapaveprues, si dhe të drejtën e transferimit të të dhënave. Gjithashtu kam të drejtë që të ushtroj ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi lidhur me pretendimet që është shkelur ligji gjatë përpunimit të të dhënave të mia personale. Banka do të më njoftoj me shkrim, nëse të dhënat e mia personale do të përpunohen për ndonjë qëllim tjetër legjitim përveç qëllimeve të sipërshënuara. Jam i informuar që për më shumë detaje në lidhje me këtë pëlqim apo çeshtje, pakënaqësi ose shqetësim tim lidhur me të dhënat e mia personale mund të kontaktoj personin përgjegjës të Bankës në çdo kohë në emalin në vijim: KS-PPD@bkt.com.al apo përmes telefoni: 038 666 666.

Pajtohem dhe jam në dijeni që të dhënat e mia personale të mbledhura nga banka për qëllimet e parapara në këtë pëlqim do të mbahen dhe të ruhen në masën që është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur. Pas përfundimit të marrëdhënies time me Bankën,

të dhënat e mia personale do të fshihen, shkatërrohen, bllokohen apo anonimizohen, përveç nëse parashihet ndryshe me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjin nr. 08/L257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, Ligjin nr. 05/L – 096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit dhe ligjeve tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.